Procesi i përzgjedhjes

Duke u bazuar tek aplikimet, DBU-ja i fton kandidatët më të mirë në një intervistë përzgjedhjeje, e cila zhvillohet në gjuhët anglisht ose gjermanisht, në vendet e tyre ose në një vend fqinj. Datat shpallen që më përpara. Të gjitha miratimet për bursën vendosen nga një komision përzgjedhës.

Detyrimet tuaja si bursist

Përfituesit e bursës angazhohen të marrin pjesë rregullisht në seminare, të paraqesin raporte, të përditësojnë informacionet e tyre në platformat e komunikimit online, të zhvillojnë aftësitë e tyre në gjuhën gjermane, si dhe të njoftojnë për çdo ndryshim në lidhje me kushtet e ndihmës financiare.

Për qëndrimin e bursistëve në Gjermani nuk nevojitet leje pune. Sidoqoftë, për të hyrë në Gjermani, për disa shtete kërkohet vizë. Përfituesit e bursës duhet të aplikojnë vetë për vizë në shtetet e tyre përkatëse.

Ish-studentë gjatë një konference në Bullgari

Paraqitja e rezultateve në një seminar

Qëndrimi juaj në Gjermani

DBU mund të ndihmojë për të gjetur një institucion pritës në Gjermani. Gjithsesi, nisma vetjake e aplikantëve çmohet së tepërmi. Angazhimi i një institucioni pritës mund të mos jetë i disponueshëm në kohën e aplikimit. Me ndihmën e DBU, një organizëm pritës mund të gjendet pas procesit pozitiv të aplikimit. Institucionet pritëse sigurojnë vendin e punës dhe garantojnë mbikëqyrje profesionale.

Për të gjithë përfituesit e rinj të bursës, kursi fillon me një seminar prezantues në Osnabruck, në të cilin shpjegohen të gjitha çështjet e rëndësishme organizative në lidhje me qëndrimin në Gjermani. Më pas, po në Osnabruck, zhvillohet kursi i gjuhës gjermane, që zgjat disa javë.

DBU i instrukton bursistët e vet gjatë gjithë periudhës së qëndrimit. Gjatë seminareve, përfituesit e bursës mund të paraqesin temat tyre, rezultatet e kërkimeve, si dhe të ndërveprojnë me njëri-tjetrin. Veç kësaj, DBU mirëpret dhe mbështet nismat individuale për të organizuar veprimtari e seminare profesionale të tjera.

DBU – ne mbështetim risinë

Fondacioni Federal Gjerman për Mjedisin (Deutsche Bundesstiftung Umwelt, DBU), në përputhje me qëllimet dhe deklaratën e misionit të tij, mbështet propozime novatore, shembullore dhe të orientuara drejt zgjidhjeve për mbrojtjen e mjedisit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Projektet që kërkojnë mbështetje duhet të synojnë të prodhojnë rezultate praktike të qëndrueshme, të shërbejnë për të siguruar një nxitës dhe të çojnë drejt një "efekti shumëzues". Objektivi i DBU-së është të kontribuojë në zgjidhjen e problemeve aktuale mjedisore, veçanërisht të atyre që burojnë nga praktika biznesi dhe mënyra jetese jo të qëndrueshme. DBU –ja i sheh sfidat e saj vendimtare kryesisht në fushat e ndryshimit klimatik, të humbjes së biodiversitetit, të përdorimit jo të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe të emetimeve të dëmshme. Temat e mbështetjes dhe projektet përkatëse lidhen si me gjetjet më të fundit shkencore përsa i përket kufizimeve planetare, ashtu dhe me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara.

Deutsche Bundesstiftung Umwelt
Postfach 1705, 49007 Osnabrück
An der Bornau 2, 49090 Osnabrück
Phone: +49 541 | 9633-0
www.dbu.de

Editor
Deutsche Bundesstiftung Umwelt

Subdivision
MOE-Stipendienprogramm
Dr. Nicole Freyer-Wille

Responsible
Prof. Dr. Markus Große Ophoff

Text and editing
Carolin Könning

Layout
Birgit Stefan

Photo credits
DBU-Archiv

Issue
S04/26

Issue: S04/26

Bursa për të diplomuar nga vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL)

në Gjermani në lidhje me mjedisin

Deutsche Bundesstiftung Umwelt

Bursiste duke përpunuar një mostër

Synimet tona për bursat në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore

DBU-ja jep deri në 50 bursa në vit për kualifikim të avancuar në të gjitha fushat e mbrojtjes së mjedisit dhe të ruajtjes së natyrës në frymën e promovimit të talenteve të reja. Janë të mirëpritur të aplikojnë studentë me kualifikim të lartë në të gjitha fushat nga vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL). Bursat e DBU-së mbulojnë një periudhë qëndrimi 6–12 mujore në një institucion mikpritës në Gjermani: universitete, institute kërkimore shkencore, kompani, agjenci dhe autoritete mjedisore e të mbrojtjes së natyrës , OJQ, shoqata etj.

Gjatë bursës përpunohen zgjidhje praktike për çështjet mjedisore aktuale . Pas përfundimit të qëndrimit të tyre në Gjermani, ish studentët janë të mirëkualifikuar për t'i trajtuar këto çështje në vendet e tyre duke siguruar kështu një transferim të efektshëm të njohurive. Bashkëpunimi i ngushtë në një kontekst ndërkombëtar ndihmon për të hequr barrierat ekzistuese. Kontaktet e vendosura do të krijojnë një rrjet të fuqishëm ekspertësh mjedisorë tejet të përkushtuar.

Ish studentë gjatë një eskskursioni në Poloni

Kërkesa zyrtare

- Nënshtetësi të këtyre vendeve: Bullgari, Estoni, Letoni, Lituani, Poloni, Rumani, Sllovaki, Republika Ceke, Ukrainë, Hungari, shtetet e Ballkanit: Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Kroaci, Maqedoni, Mali i Zi, Republika e Moldavisë, Serbi dhe Slloveni
- vendbanim në një prej shteteve pjesëmarrëse të Evropës Qendrore dhe Lindore në kohën e aplikimit
- nivel mbi mesataren (mirë dhe shumë mirë) të një prej vendeve pjesëmarrëse të EQL (Master ose Diplomë)
- të gjitha disiplinat e fushës së studimit janë të pranueshme
- në kohën e aplikimit diploma universitare nuk duhet të jetë më i vjetër se tre vjet
- studentët e doktoraturës mund të pranohen nëse tema e doktoraturës nuk përfundon gjatë periudhës së bursës
- propozim i një teme mjedisore të përshtatshme dhe të zbatueshme
- njohja e mjaftueshme e gjuhës gjermane; duhet të dëshmohet në fillim të qëndrimit në institucionin pritës

Aplikimi juaj

Aplikimi realizohet online në gjermanisht ose anglisht. Afatet e fundit të aplikimit të përvitshëm për të gjitha vendet e EQL janë 5 mars dhe 5 shtator. Më shumë informacion për afatin e fundit për vendin tuaj mund të gjeni në faqen e internetit: **https://www.dbu.de/stipendien_international**

Për aplikim online në gjermanisht ose anglisht, janë të nevojshme dokumentet e mëposhtme:

- CV
- përshkrim i një teme të mbrojtjes së mjedisit ose të ruajtjes së natyrës, për të cilën do të dëshironit të punoni në Gjermani dhe që është me rëndësi mjedisore në vendlindjen tuaj, në Komunitetin Evropian ose në nivel global
- kopje të certifikatave universitare (master, diplomë, baçellar)
- deklaratë të shkruar nga një këshilltar akademik në vendin tuaj; ose nga një mbikëqyrës
- Certifikatë të gjuhës gjermane dhe / ose angleze

Bursistë gjatë një vizite turistike

Shërbimet tona

- periudhë financimi: 6–12 muaj
- ndihma financiare mujore: 1 450 €; e përjashtuar nga taksimi dhe kontributet e sigurimeve shoqërore në Gjermani
- sigurim shëndetësor, në rast aksidenti dhe detyrime të tjera
- disa javë kurs intensiv të gjuhës gjermane në Osnabrück
- seminare për shkëmbim njohurish ndërmjet bursistëve
- ftesë për veprimtari të rëndësishme të DBU-së si »Çmimi Gjerman për Mjedisin« (German Environmental Award)
- lidhje në rrjet ndërmjet bursistëve e ish-studentëve nëpërmjet platformës online »Stipnet«
- takime vjetore të ish-studentëve në vendet e tyre përkatëse

Informacione të mëtejshme dhe kontakte

Ju lutemi, kontrolloni:
www.dbu.de/stipendien_international

për të gjithë informacionin aktual rreth programit , pyetjeve e përgjigjeve më të shpeshta, si dhe hollësive për kontaktin.

Gjithashtu, mund të kontaktoni:

- Dr. Nicole Freyer-Wille **n.freyer@dbu.de**
- Dr. Alexander Bittner **a.bittner@dbu.de**